

VENDIM
Nr. 36/2021

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 13 036, DATË 16.4.2021, TË PRESIDENTIT
TË REPUBLIKËS “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 47/2021, ‘PËR DISA SHTESA
DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 95/2016, ‘PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN
DHE KRIMIN E ORGANIZUAR””**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 13 036, datë 16.4.2021, të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr. 47/2021, ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 95/2016, ‘Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar””.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 7.5.2021.